



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1470 Prot

Tiranë më 20.3 2020

URDHËR

Nr. 4, datë 20.03.2020

“Për ndërprerjen e procesit mësimor në Universitetin e Tiranës”

Bazuar në nenin 39, pika 1 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 34, pika 2 të Statutit të Universitetit të Tiranës; në Urdhërin nr.190, datë 19.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jo publike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019”; në Urdhërin nr.97, datë 19.03.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, në cilësinë e Rektorit të Universitetit të Tiranës:

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e procesit mësimor në Universitetin e Tiranës deri në datë **03.04.2020**, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
PROF.DR.MYNYR KONI